



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 360, datë 16.6.2021

P Ë R

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN
E RINDËRTIMIT TË DY OBJEKTEVE ARSIMORE NË BASHKINË
RROGOZHINË DHE ÇAKTIMIN E BASHKISË RROGOZHINË SI NJËSI
ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” e “iii”, 16, dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të dy objekteve arsimore në Bashkinë Rrogozhinë, në masën 310 195 212 (treqind e dhjetë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e dyqind e dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, përkatësisht për:
 - a) rindërtimin e shkollës 9-vjeçare “Qamil Gjuzi”, Bashkia Rrogozhinë, në masën 137 062 762 (njëqind e tridhjetë e shtatë milionë e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH;
 - b) rindërtimin e shkollës 9-vjeçare “Lekaj”, Bashkia Rrogozhinë, në masën 173 132 450 (njëqind e shtatëdhjetë e tre milionë e njëqind e tridhjetë e dy mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.
2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2021, për financimin e rindërtimit të dy objekteve arsimore në Bashkinë Rrogozhinë, në masën 62 039 042 (gjashtëdhjetë e dy milionë e tridhjetë e nëntë mijë e dyzet

e dy) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, të ndarë, si më poshtë vijon:

- a) Për rindërtimin e shkollës 9-vjeçare “Qamil Gjuzi”, Bashkia Rrogozhinë, në masën 27 412 552 (njëzet e shtatë milionë e katërqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH;
 - b) Për rindërtimin e shkollës 9-vjeçare “Lekaj”, Bashkia Rrogozhinë, në masën 34 626 490 (tridhjetë e katër milionë e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e katërqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH.
3. Caktimin e Bashkisë Rrogozhinë si njësi zbatuese për financimin e rindërtimit të objekteve arsimore, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi.
4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Rrogozhinë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRACE

MINISTRI I SHTETIT
PËR RINDËRTIMIN

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 2941/1
DATE 17.6. 2021

MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE
MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
BASHKISË RROGOZHINË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGACI

